Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 310/20
Date/Datum 01.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**21.05.2020**	**01.06.2020**	**Nr.310/20**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën. 18.05.2020, OE "**Inter-Trading Company**"- Prishtinë, ka parashtruar ankesën me **nr.310/20**, kundër **njoftimit** për kontratë për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Vajra dhe Yndyrna për Automjete"** me nr. prokurimi 20-828-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Kompania Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A..**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, **furnizim**, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **150.000,00 €.**

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "Inter-Trading Company"

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP-së –Qëllimi
- Neni 6 i LPP-së –Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së –Barazia në trajtim/Jo diskriminimi
- Neni 28 i LPP-së –Specifikimet teknike
- Neni 70 i LPP-së – Standardet për sigurimin e cilësisë

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Pika -1

Sa i përket AK-se, lidhur me përgjigjet e dhëna, ato janë te mangëta, jo profesionale dhe te rregulluara enkas vetëm për një prodhues. Prodhuesi nga i cili AK i ka marre specifikat me pike dhe presje (www.avista-oil .de) duke i diskriminuar te gjithë OE e tjerë dhe duke ua pamundësuar pjesëmarrjen ne këtë AP.

Me datën 24.04.2020 kemi parashtruar kërkesë për sqarime pran AK-se (e bashkangjitur), dhe me datën 30.04.2020 AK kthen përgjigje kundër kërkesës për sqarime. (e bashkangjitur).

Për produktin rendor nr. 1 dhe 2, AK ka kërkuar:

Nr	Përshkrimi i shkurtër	Njesia	SPECIFICATION	APPROVALS	Sasia
1	Vaj Hidraulik ISO VG	liter	**DIN 51524-2** **FZG-Test A8,3/90 SKS:12 ISO 11158**		**15000**
2	Vaj Hidraulik ISO VG 46	liter	**DIN 51524-2** **FZG-Test A8,3/90 SKS:12** **ISO 11158**		**10000**

Ne, në mënyrë shumë te kartë AK-se munduam ti tregojmë qe **FZG-Test A8,3/90 SKS12** është metode e testimit e mbërthyer ne kërkesat minimale te standardit **DIN 51 524-2** (bashkangjitur DIN 51 524-2 dëshmia). Prodhuesi te cilin ne e përfaqësojmë, është ne regjionin e Evropës dhe përdorë standarde te Evropës siç janë DIN, dhe metodat e testimit ASTM.
Standardi DIN 51 524-2 ka kërkesat minimale te cilat duhet ti plotësoj prodhuesi i vajrave, duke i përdorur metodat e testimit siç janë dhënë
FZG ne këtë raste, ASTM, SR EN ISO etj.
FZG është e mbërthyer edhe ne DIN 51 524-2/3 dhe ISO 6743-4.
Andaj, ne me lutje kemi kërkuar nga AK qe te eliminohet ky tekst (FZG-Test A8,4/90 SKS:12) pasi qe është kriter minimal i parapare ne kërkesat minimale te DIN 51 524- Part 2 dhe qe te mos eliminohemi nga AK-ja me arsyetimin se keni ofruar specifiken FZG-Test A8,4/90 SKS:12.

Përgjigjja e AK-se, për këtë kërkesë për sqarime është:
KRM Pastrimi një numër të caktuar të kamionëve të cilët akoma janë nën gradacionin e prodhuesit. Prodhuesi i tyre e ka paraparë që ky vaj duhet të përdoret gjatë servisimit të tyre andaj n nuk kemi të drejtë ta ndryshojmë vajin e paraparë sepse e humbim gradacionin e prodhuesit. Po ashtu posedomë edhe kamion të tjerë që me rekomandim të prodhuesit duhet të përdoren vetëm vajrat e parapara nga prodhuesi.
Ndërsa ne kërkesën për ri-shqyrtim, kthen përgjigjen për vajrat hidraulike:
...përpos kësaj, kemi edhe kamion qe nuk janë ne garancinë po ne ata kamion janë instaluar kohëve te fundit pajisje te shtrenjta (si pompa hidraulik edhe aksesore te tjerë hidraulik) te cilat akoma janë nen granacionin e prodhuesit dhe mos aplikimi i vajrave adekuat e me standarde dhe miratime te caktuara teknike sipas kërkesave te prodhuesit, na e humb granacionin qe ato posedojnë.
Me gjithë respektin, sa i përket vajrave hidraulike te kërkuara nga ana juaj, keni kërkuar vetëm specifika dhe nuk keni kërkuar aprovim nga asnjë prodhues i Makinerisë apo edhe i pompave hidraulike.
C`ka është aprovimi? Aprovimi është një dokument zyrtare i lëshuar nga prodhuesi i makinerisë, prodhues i cili se bashku me ACEA (www.acea.be, www.api.org) dhe me prodhuesit e vajrave, formulojnë llojin e vajit se çfarë lloji i vajit dhe çfarë kërkesash minimale duhet ti plotësoj prodhuesi i vajit qe te prodhoj vajra adekuate për atë lloj te makinës, pompës hidraulike, dhëmbëzoreve, transmisioneve etj.
Pas përpilimit te kërkesave minimale, ato i bëjnë publike dhe prodhuesit e vajrave munde ti blejnë kërkesat, te prodhojnë vajin ne baze te kërkesave te përdoruesit (prodhuesit te makinerisë) dhe t`i dërgoj mostrat e vajit pran prodhuesit te makinerisë për testime.
Nëse prodhuesi i vajrave i ka përmbushur kriteret e kërkuara nga prodhuesi i makinerisë, atëherë i lëshohet "aprovimi" për produktin me shifër te produktit, i cili është aprovuar nga prodhuesi i makinerisë për përdorim ne pajisjet e tije.
Ne produktin e kërkuar nr 1 dhe nr 2 ju si AK nuk keni kërkuar fare aprovime nga asnjë prodhues, dhe nuk e di qysh mundeni me deklarua qe humb garancinë nëse s'përdoret ky vaj i kërkuar, kur asnjë prodhues nuk te jep garancion sepse nuk e keni specifikuar se për çka është kërkuar përdorimi/mbulimi i garancionit, aprovimi

apo kërkesat minimale?!
Nëse do te ishte për përdorim ne pompa hidraulike te BOSCH, at`her do te ishte e kuptueshme te kërkohet vaji me specifika te B OSCH e po ashtu edhe aprovimi nga BOSCH.

Pika -2

Aneksi 1 i dosjes se tenderit, gjegjësisht specifikimet teknike te detyrueshme, AK per produktet rendore 3 ka kërkuar:

Nr	Përshkrimi i shkurtër	Njesia	SPECIFICATION	APPROVALS	
3	VAJ MOTORRI SAE 15W40 (PER MJETE TE RENDA LKW	liter	ACEA A3/B4 **E7; API SL; JASO DH-1-17; Global DHD-1; Cummins CES 20078; Detroit Diesel DDC93K215; MTU TYPE2**	**API CI-4; Deutz dqc II!-10; Mack EO-N; MAN M3275-1; MB-Ffreigabe 228.3 229.1;**	

Është kërkuar ``**VAJ MOTORI SAE 15W-40/PER MJETE TE RENDA OSE LKW** shkurtes e gjuhës Gjermane "Lastkraftwagen"
Ndërsa, ne specifikat e kërkuar është edhe:
ACEA A3/B4- Kjo specifike është për vetura te lehta, jo per kamionë!!!
Ndërsa, për mjetet e renda ne baze te ACEA është shifra:
Siç edhe ka kërkuar AK ne ketë raste ACEA E7
Kemi kërkuar nga AK qe te eliminohet kjo pasi qe nuk ka te bej me produktin e kërkuar, sepse është kërkuar vaj për mjete te r enda dhe jo për vetura.
Kemi kërkuar nga AK-ja, qe ne baze te JASO DH-1-17 pasi qe është standard i Japonisë dhe prodhuesit Evropian shpeshherë nuk e përdorin standardin Japan, mirëpo, ky standard është i përthyeshëm ne API (American Petroleum Institutin.
Skema e përgatitur nga seminari I mbajtur ne Evropë ne mes te ACEA, API dhe JASO:
Qe do te thotë qe secili vaj i aprovuar nga API CH-4 e gjer API CJ-4 është ekuivalent i JASO DH-1 siç është kërkuar nga AK-ja.
Ne, nga ky AK jemi eliminuar ne vitin 2017 me arsyetimin ``keni ofruar produkte me standarde me te larta sesa ato qe ne kemi kërkuar dhe nuk po duam qe te eliminohemi prape për te njëjtin arsyetim!!!
Kemi ofruar edhe dëshmi nga një pale e trete e pavarur, qe deklaron qe është standard i përthyeshëm dhe ekuivalent. Ndërsa, sa i përket rubrikës ``APPROVALS`` AK ka kërkuar:
MB 228.3- Aprovimi nga Mercedes- Benz për përdorime ne motorë te mjeteve te renda qe është kërkesë me vend.
MB 229.1- Kjo shifër, do te zëvendësohet nga Merces Benz dhe thotë, Përdore alternativen MB 229.3 or MB 229.5
MB 229.3 është shifër për përdorime ne motorë te veturave. Kërkojmë qe shifra MB 229.1 te eliminohet e po ashtu edhe aprovimi dhe te kërkohet aprovimi vetëm për MB 228.3 qe është i mjeteve te renda, 229.1H
MB 229.3 është vaj për përdorim ne mjete te lehta (vetura) MB 229.5 është vaj për përdorim ne mjete te lehta (vetura)
MB 228.3 është vaj për përdorim ne mjete te renda (Kamion, traktor, gjenerator etj). Skema nga Mercedes:

Andaj, kemi kërkuar qe te eliminohet shifra MB 229.1 pasi qe nuk është specifike e vajit për mjete te renda dhe prodhuesit te cilët rrinë ne hap me kohen, nuk kamuflojnë me specifika dhe i përditësojnë te njëjta.
Është kërkuar aprovimi nga Deutz DQC-III-10
Është kërkuar aprovimi nga MAN M 3275-1
Është kërkuar aprovimi nga Renault dhe Volvo
Ne përgjigjen e dhënë nga AK kundrejt kërkesave për sqarime, AK për këtë pozicion deklaron:
KRM Pastrimi një numër të caktuar të kamionëve të cilët akoma janë nën garancionin e prodhuesit. Prodhuesi i tyre e ka paraparë që ky vaj duhet të përdoret gjatë servisimit të tyre andaj n nuk kemi të drejtë ta ndryshojmë vajin e paraparë sepse e humbim garancionin e prodhuesit. Po ashtu posedomë edhe kamion të tjerë që me rekomandim të prodhuesit duhet të përdoren vetëm vajrat e parapara nga prodhuesi..
Me gjithë respektin ndaj AK-se, nëse keni ndonjë kamionë qe është nen garancion, ai atëherë duhet te jete Mercedes-Benz, MAN, Deutz, Renault ose Volvo pasi qe për këto është kërkuar aprovimi, ndërsa ne rubrikën "specification" janë kërkuar tjera specifika qe nuk ka kërkesa për aprovime mirëpo vetëm specifika te dhëna qe njihen ndryshe edhe si ``meet requirements``.

Nëse po, atëherë me ligjin ndërkombëtarë te ruajtjes dhe konkurrencës, asnjë prodhues i MAKINERIVE nuk guxon te diskriminoj prodhuesit tjerë te vajrave, duke e obliguar blerësin te përdor vetëm një brend.
Mundet te përdor termin ``referoj``, mirëpo nuk mundet te eliminoje prodhuesit e vajrave e sidomos ata qe janë te aprovuar nga vete prodhuesit e makinerive.

Shembull:
Nëse AK ka ne pronësi kamion te tipit Mercedes-Benz, ne e dijme qe Mercedes Benz preferon brendin ``MOBIL``(shkaqe financiare) Mirëpo, nëse Mercedes Benz aprovon edhe prodhues tjerë te vajrave, nuk do te thotë qe garancioni nuk vlen nëse përdoret brend tjetër, për aq kohe sa është i aprovuar nga Mercedes Benz!!!
Ju si AK ne tabelën ``SPECIFICATION`` keni kërkuar specifika tjera, ndërsa tek aprovimet keni kërkuar për MAN, MB, VOLVO, RENAULT, DEUTZ ETJ.
Tash, kriter i vlerësimit do te jene qe te dy rubrikat, mirëpo superiore është ajo ne te aprovuarat pasi qe ajo është e cila garanton cilësinë. Me lutje kërkojmë nga AK-ja, qe tek ky pozicion te eliminohen:
ACEA A3/B4
JASO DH-1-17 ose te kërkohet standardi ekuivalent API CI-4 minimum!!!!
MB 229.1 kërkesa dhe aprovimi te eliminohen pasi qe s'kanë te bëjnë me këtë kategori.
Dhe po ashtu, ti mundësohet OE te merr pjese me vajra te cilësisë me te larte, gjithmonë duke dëshmuar nga një pale e trete e pavarur, me dosje teknike dhe te dhëna te cilat dëshmojnë qe i përmbush kërkesat e AK-se, duke u bazuar edhe ne LPP-ne ne fuqi, neni 28.

Pika -3
AK për artikullin nr. 6 ka kukuar:

Nr	Përshkrimi i shkurtër	Njësia	SPECIFICATION	APPROVALS	Sasia
6	VAJI MOTORRI SAE 10W-40	litër	**ACEA A3/B4; Renault RN 0700; VW VW501 01/ 505 00**	**API SN; MB-**	**700**

Edhe një here, shifra e kërkuar nga MB 229.1 do te zëvendësohet me shifrën MB 229.3, dëshmia nga MB: 229.1H

Kemi kërkuar qe te na lejohet te marrim pjesë me VW 502.00 (e kërkuar VW 501.00) ku kemi ofruar dëshmi mirëpo një gjë e tille nuk ne është mundësuar!!!
VW 502.00
Vajrat e prodhuesve me renome te cilësisë se larte, zakonisht vajin 10w-40 e kanë me specifiken VW 502 00/505 00 andaj kërkojmë nga AK-ja qe te na mundësojë te marrim pjese me shifrën VW 502 00/505 00
Ne, me lutje kemi kërkuar nga AK-ja qe te na mundësoj te marrim pjesë me produkt te aprovuar nga Mercedes Benz me shifrën MB 229.3
Prodhuesi qe ne përfaqësojmë, është njeri nga konsorciumet kryesore te Mercedes Benz dhe është gjithnjë ne hap me kohen dhe p përditësimin e kualitetit.
cilësisë dhe kërkesave te kërkuara nga Mercedes Benz.
Te njëjta dëshmi janë dorëzuar edhe pran AK-se mirëpo nuk janë marre parasysh fare.

Pika -4
Ak për artikullin nr.8 ka kërkuar:

Nr.	Përshkrimi i shkurtër	Njësia	SPECIFICATION	APPROVALS	Sasia
	VAJ PER NDERRUES AUTOMATIK ATFD-III-	litër	**GM Dexron III-H**	**MB- Freigabe 236.9;MB-Freigabe236.1;MAN 339 Typ L-1/V-1/Z-1; Voith 55.6335.xx; ZF TE-ML 03D,04D,14A, 17C(zf004774**	

Me lutje kemi kërkuar nga AK-ja qe te na mundësoj te marrim pjesë me produkt me cilësore dhe te mos na diskriminoj duke vendosur specifika saktësisht për vetëm një prodhues, ne këtë raste AVISTA OIL.

E kërkuar nga AK:	E ofruar nga OE:
MB 236.9 approved	MB 236.9 approved (meets MB 236.10/ MB 236.11) MB 236.1 approved MB 236.6 approved
MAN 339 Typ L1/V1/Z1	MAN 339 Typ L1/V2/Z2/Z1
ZF TE ML 03D, 04D, 14A, 17C (ZF004774)	ZF TE ML 04D, 14B, 16L, 16R, 20B, 25B

Kemi kërkuar nga AK qe te na mundësohet te marrim pjese me produkt i cili është IDENTIK si i kërkuar nga AK-ja, për vetëm një shkalle te cilësisë me te larte, gjë qe nuk e ka lejuar te njëjtën duke na diskriminuar dhe eliminuar mundësinë e ofrimit te produktit me cilësore i cili është ne përputhje 100% me atë te kërkuar ne Aneksin 1 specifikat (ATF D III-H)
AK për këtë produkt i është përshtatur 100% produktit te AVISTA OIL, ku ka ofruar edhe numrin e licencës te produktit (ZF004774):

Pika -5
Ak për artikullin nr. 11-14 AK ka kërkuar:

Nr	Përshkrimi i shkurtër	Njësia	SPECIFICATION	APPROVALS	Sasia
11	YNDYRË PËR LUBRIFIKIM E HOLLË	kg	**FUEL PROVISION 264;FACTORY STANDARD**		**1200 KG**
12	YNDYRE PER LUBRIFIKIM E HOLLE NLGI - 1	kg	**FUEL PROVISION 264;FACTORY STANDARD 283Li-P00**		**1200 KG**
13	YNDYRE PER LUBRIFIKIM E TRASH NLGI-2 për DORË	kg	**FUEL PROVISION 267;FACTORY STANDARD 283Li-P2**		**600 KG**
14	YNDYRE PER LUBRIFIKIM E TRASHE	Kg	**FUEL PROVISION 267;FACTORY STANDARD 283Li-P2**		**400 KG**

Ne, kemi kërkuar nga AK-ja sqarime lidhur me produktet e kërkuara, pasi qe specifikat janë te marra nga vetëm një prodhues dhe nuk janë te sakta.

Ne kërkesën tone për sqarime për produktin rendore nr 12 kemi kërkuar sqarime nga AK-ja pasi qe ne rubrikën ``përshkrimi i shkurtër`` ishte Yndyre Për lubrifikim e holle NLGI-1 ndërsa tek rubrika ``specificaiton`` ishte dhënë standardë 283 LI POO =>(NLGI- 00). AK kthen përgjigje qe shkalla duhet te jete NLGI-1

Edhe këto specifika janë marre direkt nga produkti i AVISTA dhe janë te dhëna gabim

FUEL PROVISION 264 është term i gabuar pasi qe kërkesa duhet te jete Mercedes Benz MB 264 per NLGI 00

FUEL PROVISION 267 është term i gabuar pasi qe kërkesa duhet te jete Mercedes Benz MB 267 per NLGI 2

Ndërsa, Factory standard 283LI-P00 është shifër e MAN 283-Li-P00

(SHKALLA NLGI 00) Factory standard 283LI-P2 është shifër e MAN

283-Li-P2 (SHKALLA NLGI 2)

Ne, kemi ofruar edhe skemën e MAN pasi qe AK për produktin rendore nr 12 ka treguar qe duhet te jete NLGI 0.

Kjo është ne kundërshtim pasi qe MAN 283 LI POO është vete identifikuese qe shkalla duhet te jete NLGI 00 dhe jo NLGI 1.

Ne mënyrë shumë te qarte identifikohet qe MAN 283 Li- P ka shkalle NLGI 00 dhe NLGI 2, ndërsa nuk ka NLGI 1 dhe nuk mundet sepse nuk ekziston!

Nëse ne do te merrnim pjese ne këtë AP, jemi mese te siguritë qe edhe nëse do te ofronim faktet e dhëna ne këta ankesë, nuk do te merreshin parasysh dhe do te eliminoheshim, siç jemi eliminuar ne vitin 2018 për arsyetimin se kemi ofruar produkte me standard me te larte (e bashkangjitur letra standarde për tënd. Eliminuar). Ne, kemi paralajmëruar AK përmes kërkesës për sqarim dhe kërkesës për ri-shqyrtim se te gjitha produktet janë te dhëna ne baze te specifikave te prodhuesit AVISTA.oil gjë qe është diskriminuese dhe ngushton konkurrencën ne vetëm një OE. AK, për çudi kthen përgjigjen:

Me vete faktin qe për vajrat e tilla nuk ka asnjë përfaqësues gjeneral ne Kosove dhe te njëjta mund te blihen gjithandej tregjeve evropiane dhe botërore, nënkupton se këtë produkt mundet ta liferoj ne Kosove secila kompani qe posedon licencën nga autoritetet Kosovar e dhe qe e gjene furnitorin adekuat për te bere marrëveshje. Duhet te jete e qarte se vajrat bien ne grupin e pjesëve rezerve qe janë te nevojshme për mirëmbajtje te makinerive te tilla andaj është e ndaluar edhe nga aspekti inxhinierisë qe te aplikojmë tek makineritë e tilla diçka qe nuk i përgjigjet teknikisht sipas katalogëve dhe përshkrimeve te prodhuesit. Pra, bazuar faktin se për produktet ne fjale nuk ka ndonjë kufizim importi dhe te njëjtin mundet ta bëjnë shumë OE, konsiderojmë se nuk kemi te bëjmë me shkeljen te nenit 7 te LPP-se dhe se ky pretendim hidhet poshtë si i pa-bazuar. Ne, e falënderojmë AK qe ka hulumtuar qe nëse ky prodhues ka apo nuk ka përfaqësues për Kosove. Ne, kemi kontaktuar me prodhuesin AVISTA OIL dhe i njëjti na ka konfirmuar qe KA përfaqësues

EKSKLUZIV për Kosove. Edhe po te mos kishte përfaqësues, ne dosjen e tenderit ju si AK keni kërkuar: Te ofrohet autorizimi nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar, gje qe e pamundëson pjesëmarrjen ne këtë AP dhe ngushton konkurrencën ne vetëm një OE. Andaj, duke u bazuar ne te gjitha këto fakte dhe argumente, kërkojmë nga OSHP-ja qe ankesën tone ta shqyrtoje ne mënyrë profesione dhe te njëjtën ta aprovoj si te bazuar dhe te kërkoj nga AK qe te lejoj OE me produkte me cilësore dhe te mos vendo s kërkesa dhe specifika te vjetra e te panevojshme, te cilat nuk janë te nevojshme dhe janë te mbi-ngarkuara, qe diskriminojnë prodhuesit tjerë, duke e zvogëluar konkurrencën vetëm ne një prodhues dhe po ashtu, duke eliminuar mundësinë e prodhuesve me renome te cilët kanë produkte shume me cilësore sesa te prodhuesit qe AK ka favorizuar ne këtë AP.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

-Pretendimet e OE lidhen me specifikimet teknike.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Te përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës se OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Raporti vlerësimit nuk është bere.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre informacion shtese eksperti shqyrtues.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues eshte pale e interesit ne kete aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasur vendim te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Inter-Trading Company"

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se në pozicionin 1 dhe 2 të specifikimit teknik nga AK është vendosur teksti (FZG-Test A8,4/90 SKS:12) i cili është kriter minimal te DIN 51 524-2 dhe i njëjti kërkojmë që të largohet në mënyrë që mos të eliminohemi me arsyetimin se nuk e kemi ofruar të njëjtin, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Te kolona e tabelës aë specifikimit teknik të dosjes së tenderit me shprehjen "Specifikation" për pozicionin 1 dhe 2 ku është e shënuar teksti (FZG-Test A8,4/90 SKS:12), të largohet krejtësisht ose ti shtohet edhe fjalia "Ekuivalent ose më i avancuar" në mënyrë që OE mos të diskriminohen nëse ofrojnë produkte më të avancuar se ky i kërkuara.
Në formën si është shkuar nga AK paraqet kufizim të pjesëmarrjes për ofertuesit që ofrojnë produkte më të avancuar nga prodhuesit të ndryshëm që plotësojnë kriteret nga shtetet e bashkimit evropian. Prandaj e konsideroj si pretendim ankimor të **bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues që ka te beje me specifikimet teknike te pozicioni nr.3 në listën e specifikimit teknik ku është kërkuar ACEA A3/B4 E17 SL: JASO DH-1-17 për të cilën kemi kërkuar nga AK që të eliminohet ACEA E7 sepse nuk ka të bëjë me produktet e kërkuara për mjetet e rënda por për vetura. Po ashtu nga AK kemi kërkua që JASO DH-1-17 si standard japonez të mund të zëvendësohet si Ekuivalent me vajin e aprovuar nga API CH-4 e gjerë API CJ-4. Po ashtu te aprovimi MB 229.1 të eliminohet
dhe të përdoren alternativa, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Specifikimi në këtë pozicion për ofrimin e produkteve të vajrave me një standard të veçantë pa lejuar edhe alternativa të tjera të cilësisë së njëjtë apo edhe më të avancuara, mundet të jetë diskriminueses për shumë ofertues dhe favorizuese për prodhues të caktuar.
Prandaj edhe këtij pozicioni ti shtohet fjala "Ekuivalent ose më i avancuar" në mënyrë tenderuesit të ofertojnë me produkte të cilësisë së njëjtë ose edhe me cilësi më të lartë se që është kërkuar nga AK. Po ashtu aprovimi me shifrën MB 229.1 të lejohet me shifra alternative të cilat nuk e dëmtojnë cilësinë e kërkuar. Eksperti shqyrtues e vlerëson edhe këtë pretendim ankimor të **bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Pretendimi i tjetër i OE ankues se në pozicionin nr.6 është kërkuar aprovimi MB 229.1 dhe shifra VW 501 01 që është shifër e vjetër deri në vitin 1999 dhe kërkojmë që të pranohet produktet me aprovim të Mercedes Benzit MB 229.3 dhe po ashtu shifra VW 501 01 të mundet të zëvendësohet edhe me shifrën VW 502 00, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Për mendimin e ekspertit shqyrtues edhe në këtë pozicion duhet të mundësohet aplikimi me aprovim të Mercedes Benzit me shifrën MB 229.3 dhe po ashtu të pranohet edhe shifra VW 502 00 sepse këto nuk e dobësojnë cilësinë e kërkuar, përkundrazi ofrojnë çasje më të shumë të ofertuesve. Edhe në këto pozicion duhet të mundësohet edhe prodhuesve të tjerë që aplikojnë sipas standardeve te bashkimit evropian. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.4

Pretendimi i tjetër i OE ankues se në pozicionin nr.8 nga AK janë kërkuar specifika vetëm të një prodhuesi "AVISTA OIL" dhe ne kemi kërkuar prej AK që të na mundësohet ofertimi edhe me produkte të prodhuesve të tjerë po nuk na është pranuar, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues mundet ti referohet një prodhuesi, mirëpo jo të eliminohen ofertuesit që konkurrojnë me produkte të prodhuesve të tjerë që kanë cilësinë identike apo edhe më të lartë. Prandaj rekomandojmë AK që edhe për këtë pozicion të shtohet fjalia "Ekuivalentë ose me e avancuar" në mënyrë që ti mundohet OE të ofertojnë edhe me produkte të prodhuesve të tjerë që ofrojnë cilësi të standardit të kërkuar apo edhe më të lartë. Është e pa pranueshme dhe në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së përshtatja e specifikimeve teknike një prodhuesi të caktuar dhe diskriminimi i operatorëve ekonomik që ofertojnë me produkte të prodhuesve të tjerë. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.5

Pretendimi i fundit i OE ankues se në pozicionin nr.11, 12, 13 dhe 14 nga AK po ashtu janë marrë specifikat nga një prodhues dhe nuk janë të sakta. Yndyrë për lubrifikim e hollë NLGI 00 produkti nr.11 dhe 12. AK në sqarime shtesë kërkon që për produktin nr.12 të ofrohet shkalla NLGI-1 e cila nuk ekziston. Edhe këto specifika janë marrë direkt nga prodhuesi AVISTA dhe janë gabim. Kjo mënyrë e ngushton konkurrencën, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Edhe në pozicionet në fjalë për të cilën është ngritur pretendimi ankimor duhet nga AK të bëhen përmirësimet e nevojshme në specifikim teknik në mënyrë që të ju jepet mundësia e ofertimit edhe me produkte të prodhuesve të tjerë të këtyre yndyrave për lubrifikim. Gjithashtu të shtohet fjalia "Ekuivalente ose më të avancuara" në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e sa më shumë ofertuesve me produkte të prodhuesve të ndryshëm që kanë cilësinë e njëjtë të produkteve apo edhe më të avancuara se ato që janë kërkuar nga AK.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka hartuar specifikacionin teknik për produktet e kërkuara në atë mënyrë që e ngushtojnë konkurrencën dhe favorizojnë produkte të një prodhuesi të caktuar. Kjo është në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së. Prandaj rekomandohet që autoriteti kontraktues ta korrigjoj specifikimin teknik dhe të shtoj shprehjen ekuivalente ose më të avancuar në mënyrë që të zgjerohet konkurrenca dhe të ju mundësohet ofertimi më shumë OE të interesuar.

Është e pakuptim dhe jo ligjore qëndrimi i AK-së se automjetet që kanë në dispozicion janë në afatin e garancionit dhe nuk lejohet vaj me specifika të tjera teknike se ato që janë vendosur në DT. Asnjë prodhues i automjeteve nuk kufizon kompanitë prodhuese të vajit, duke favorizuar vetëm një prodhues. Vaji i motorëve të automjeteve është e rëndësishme që ti plotësoj cilësitë e duhura lubrifikuese në bazë të parametrave teknik dhe sipas standardeve përkatëse që ofrojnë prodhuesit e ndryshëm por në asnjë mënyrë nuk mundet të caktohet një prodhues i veçantë i produkteve të caktuara të vajit. Po ashtu çdo produkt i ofruar nga operatorët ekonomik ofertues me cilësi dhe kualitet më të lartë se ai i kërkuar në DT duhet të pranohet nga AK.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e Operatorit Ekonomik ankues të **aprovohet si e bazuar.**

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të korrigjoj specifikimin teknik sipas rekomandimeve të dhëna më lartë për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Vajra dhe Yndyrna për Automjete" me nr.prokurimi 20-828-1-1-1**.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Kompania Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A...
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Inter-Trading Company"